

# MSH 2021

## LËNDA: BIOLOGJI

### VARIANTI A

#### PËRGJIGJET E PYETJEVE TË TESTIT

Pyetja 1      C      1 pikë

Pyetja 2      A      1 pikë

Pyetja 3      B      1 pikë

Pyetja 4              3 pikë

**Përgjigje:**

**3 pikë**

*Përcakton numrin e secilës prej bazave të azotuara A dhe G në këtë molekulë AND-je. 1 pikë*

$$A + G + C + T = 1200$$

$$2G + G + G + 2G = 1200$$

$$G = 200$$

$$A = 2G \quad A = 400$$

*Përcakton numrin e secilës prej bazave të azotuara T dhe C në këtë molekulë AND-je. 1 pikë*

$$C = G \quad C = 200$$

$$T = A \quad T = 400$$

*Përcakton numrin e lidhjeve hidrogjenore në këtë molekulë AND-je. 1 pikë*

$$A = 400 \quad T = 400$$

Midis A dhe T ka 800 lidhje hidrogjenore

$$C = 200 \quad G = 200$$

Midis C dhe G ka 600 lidhje hidrogjenore

$800 + 600 = 1400$  lidhje hidrogjenore

## 2 pikë

Përcakton numrin e secilës prej bazave të azotuara A dhe G në këtë molekulë ADN-je. **1 pikë**

Përcakton numrin e secilës prej bazave të azotuara T dhe C në këtë molekulë ADN-je. **1 pikë**

## 1 pikë

Përcakton numrin e secilës prej bazave të azotuara A dhe G në këtë molekulë ADN-je. **1 pikë**

## 0 pikë

Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 5      A      1 pikë

Pyetja 6      D      1 pikë

Pyetja 7      3 pikë

Pyetja 7 (a)      2 pikë

## Përgjigje:

### 2 pikë

Arsyeton në bazë të rezultateve të kryqëzimit të I-rë, për vendosjen e gjeneve A dhe B në kromozomet homologe **1 pikë**

Prindërit: ♀ AaBb x ♂ aabb

Pasardhësit: 238 AaBb, 237 Aabb, 238 aaBb, 239 aabb

Meqënëse formohen pasardhës afërsisht në raportin 1:1:1:1 atëherë gjenet A dhe B janë të pavarur (ose të lirë)dhe ndodhen në çifte të ndryshme kromozomesh homologe.

Arsyeton në bazë të rezultateve të kryqëzimit të II-të, për vendosjen e gjeneve D dhe E në kromozomet homologe **1 pikë**

Prindërit: ♀ DdEe x ♂ ddee

Pasardhësit: 432 Ddee; 428 ddEe; 68 DdEe; 72 ddee.

432 Ddee	prindërorë
428 ddEe	prindërorë
68 DdEe	rikombinantë
72 ddee	rikombinantë

Meqënëse formohen pasardhës me numër të ndryshëm (prindërorët me numër më të lartë dhe rikombinantët me numër më të ulët), gjenet D dhe E janë të lidhur dhe midis tyre ka ndodhur kryqëmbimi.

**1 pikë**

Arsyeton në bazë të rezultateve të kryqëzimit, për vendosjen e gjeneve A dhe B në kromozomet homologe **1 pikë**

Ose

Arsyeton në bazë të rezultateve të kryqëzimit, për vendosjen e gjeneve D dhe E në kromozomet homologe **1 pikë**

**0 pikë**

Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 7 (b) 1 pikë**

**Përgjigje:**

**1 pikë**

Ilustron me skemë vendosjen e gjeneve D dhe E në kromozomet homologe **1 pikë**

Gjenet D dhe E janë të lidhur.

Mënyra e vendosjes së gjeneve në kromozomet homologe është:



**0 pikë**

Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 8 3 pikë**

**Përgjigje:**

*Mënyra e parë*

**3 pikë**

*Përcakton gjenotipet e prindërve. 1 pikë*

**P:** ♀  $I^A I^B$  x ♂  $I^B I^0$

**P:** ♀  $X^D X^d$  x ♂  $X^D Y$

*Përcakton tipet e gametëve që prodhojnë prindërit. 1 pikë*

**P:** ♀  $I^A I^B$  x ♂  $I^B I^0$

P: ♀  $I^A I^B$  prodhon gametët  $I^A$  dhe  $I^B$

P: ♂  $I^B I^0$  prodhon gametët  $I^B$  dhe  $I^0$

**P:** ♀  $X^D X^d$  x ♂  $X^D Y$

P: ♀  $X^D X^d$  prodhon gametët  $X^D$  dhe  $X^d$

P: ♂  $X^D Y$  prodhon gametët  $X^D$  dhe  $Y$

*Njehson sa është mundësia që vajza të ketë grup gjaku AB dhe të jetë jodaltonike. 1 pikë*

**P:** ♀  $I^A I^B$  x ♂  $I^B I^0$

♀/♂	$I^A$	$I^B$
$I^B$	$I^A I^B$	$I^B I^B$
$I^0$	$I^A I^0$	$I^B I^0$

**P:** ♀  $X^D X^d$  x ♂  $X^D Y$

♀/♂	X <sup>D</sup>	X <sup>d</sup>
X <sup>D</sup>	X <sup>D</sup> X <sup>D</sup>	X <sup>D</sup> X <sup>d</sup>
Y	X <sup>D</sup> Y	X <sup>d</sup> Y

$$1/4 \times 3/4 = 3/16$$

**2 pikë**

Përcakton gjenotipet e prindërve. **1 pikë**

Përcakton tipet e gametëve që prodhojnë prindërit. **1 pikë**

**1 pikë**

Përcakton gjenotipet e prindërve. **1 pikë**

**0 pikë**

Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Mënyra e dytë**

**3 pikë**

Përcakton gjenotipet e prindërve. **1 pikë**

**P:** ♀ I<sup>A</sup> I<sup>B</sup> X<sup>D</sup> X<sup>d</sup> x ♂ I<sup>B</sup> I<sup>0</sup> X<sup>D</sup> Y

Përcakton tipet e gametëve që prodhojnë prindërit. **1 pikë**

♀/♂	I <sup>A</sup> X <sup>D</sup>	I <sup>A</sup> X <sup>d</sup>	I <sup>B</sup> X <sup>D</sup>	I <sup>B</sup> X <sup>d</sup>
I <sup>B</sup> X <sup>D</sup>	I <sup>A</sup> I <sup>B</sup> X <sup>D</sup> X <sup>D</sup>	I <sup>A</sup> I <sup>B</sup> X <sup>D</sup> X <sup>d</sup>	I <sup>B</sup> I <sup>B</sup> X <sup>D</sup> X <sup>D</sup>	I <sup>B</sup> I <sup>B</sup> X <sup>D</sup> X <sup>d</sup>
I <sup>B</sup> Y	I <sup>A</sup> I <sup>B</sup> X <sup>D</sup> Y	I <sup>A</sup> I <sup>B</sup> X <sup>d</sup> Y	I <sup>B</sup> I <sup>B</sup> X <sup>D</sup> Y	I <sup>B</sup> I <sup>B</sup> X <sup>d</sup> Y
I <sup>0</sup> X <sup>D</sup>	I <sup>A</sup> I <sup>0</sup> X <sup>D</sup> X <sup>D</sup>	I <sup>A</sup> I <sup>0</sup> X <sup>D</sup> X <sup>d</sup>	I <sup>B</sup> I <sup>0</sup> X <sup>D</sup> X <sup>D</sup>	I <sup>B</sup> I <sup>0</sup> X <sup>D</sup> X <sup>d</sup>
I <sup>0</sup> Y	I <sup>A</sup> I <sup>0</sup> X <sup>D</sup> Y	I <sup>A</sup> I <sup>0</sup> X <sup>d</sup> Y	I <sup>B</sup> I <sup>0</sup> X <sup>D</sup> Y	I <sup>B</sup> I <sup>0</sup> X <sup>d</sup> Y

Njehson sa është mundësia që fëmija të ketë grup gjaku AB dhe të jetë jodaltonik **1 pikë**

Mundësia që fëmija të jetë grup gjaku AB dhe të mos jetë daltonik është **3/16**.

**Pyetja 9      B      1 pikë**

**Pyetja 10    3 pikë**

**Përgjigje:**

**3 pikë**

*Njehson vlerën e  $q$ -së 1 pikë*

$$q^2 = 0,01$$

$$q = 0,1$$

*Njehson vlerën e  $p$ -së 1 pikë*

$$p = 0,9.$$

*Njehson vlerën e  $2pq$ -së 1 pikë*

$$2pq = 2 \times 0,9 \times 0,1 = \mathbf{0,18}$$

**2 pikë**

*Njehson vlerën e  $q$ -së 1 pikë*

$$q^2 = 0,01$$

$$q = 0,1$$

*Njehson vlerën e  $p$ -së 1 pikë*

$$p = 0,9.$$

**1 pikë**

*Njehson vlerën e  $q$ -së 1 pikë*

$$q^2 = 0,01$$

$$q = 0,1$$

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

## **Pyetja 11 3 pikë**

**Pyetja 11 (a) 1 pikë**


**Përgjigje:**

**1 pikë**

*Arsyeton për llojin e gazit që çliroi bima dhe origjinën e tij **1 pikë***

Në prani të energjisë së dritës bima zhvillon procesin e fotosintezës.

Gjatë fazës në dritë të fotosintezës ndodh fotoliza e ujit, nga ku O<sub>2</sub> çlirohet në mjedis.



**Ose**

Në prani të energjisë së dritës bima zhvillon procesin e fotosintezës.

Gjatë fazës në dritë të fotosintezës ndodh fotoliza e ujit, nga ku O<sub>2</sub> çlirohet në mjedis.

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

**Pyetja 11 (b) 1 pikë**

**Përgjigje:**

**1 pikë**

*Arsyeton për varësinë e shpejtësisë së fotosintezës, duke bërë krahasimin midis pikave A dhe B të grafikut **1 pikë***

Duke iu referuar pikave A dhe B të grafikut, shohim që me rritjen e intensitetit të dritës rritet shpejtësia e fotosintezës.

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

**Pyetja 11 (c) 1 pikë**

**Përgjigje:**

*Arsyeton për varësinë e shpejtësisë së fotosintezës nga intensiteti i dritës, duke bërë krahasimin midis pikave C dhe D të grafikut **1 pikë***

Duke iu referuar pikave C dhe D të grafikut, shohim që me rritjen e mëtejshme të intensitetit të dritës shpejtësia e fotosintezës mbetet konstant.

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*


**Pyetja 12 2 pikë**

**Pyetja 12 (a) 1 pikë**

**Përgjigje:**

**1 pikë**

*Shkruan reaksionin e përgjithshëm të frymëmarrjes qelizore **1 pikë***



**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

**Pyetja 12 (b) 1 pikë**

**Përgjigje:**

**1 pikë**

*Tregon dallimin midis frymëmarrjes qelizore dhe fermentimit duke iu referuar sasisë së energjisë së çliruar **1 pikë***

Gjatë procesit të fermentimit formohen 2 ATP, kurse gjatë frymëmarrjes qelizore formohen 36 (ose 38) ATP.

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

**Pyetja 13 3 pikë**


**Pyetja 13 (a) 1 pikë**

**Përgjigje:**



**1 pikë**

*Ilustron me skemë qelizën në fund të metafazës. 1 pikë*



**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

**Pyetja 13 (b) 1 pikë**

**Përgjigje:**

**1 pikë**

*Ilustron me skemë qelizën në fund të anafazës. 1 pikë*



**0 pikë**


*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

**Pyetja 13 (c) 1 pikë**

**Përgjigje:**

**1 pikë**

Arsyeton për të njehsuar numrin e kromozomeve në fund të telofazës. **1 pikë**



Në ndarjen me mitozë qeliza mëmë ndahet në dy qeliza bija, që kanë numur të njëjtë kromozomesh me qelizën mëmë. Secila nga qelizat, në fund të telofazës ka nga 4 kromozome.

**Ose**

Në ndarjen me mitozë qeliza mëmë ndahet në dy qeliza bija, që kanë numur të njëjtë kromozomesh me qelizën mëmë. Secila nga qelizat, në fund të telofazës ka nga 4 kromozome.

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

**Pyetja 14    A    1 pikë**

**Pyetja 15    C    1 pikë**

**Pyetja 16    3 pikë**

**Pyetja 16 (a) 2 pikë**

**Përgjigje:**

**2 pikë**

*Shpjegon kushtet për arritjen e turgorit në qelizat bimore **1 pikë***

Kur qeliza bimore është e zhytur në ujë të distiluar ose tretësirë të holluar, uji me anë të osmozës hyn brenda në qelizë, duke kaluar përmes membranës gjysëm të përshkrueshme, vëllimi i qelizës

rritet, qeliza fryhet dhe citoplazma ushtron trysni mbi membranën duke kaluar në gjëndje të turguar.

*Shpjegon kushtet për arritjen e plazmolizës në qelizat bimore 1 pikë*

Kur qeliza bimore është e zhytur në një tretësirë të përqëndruar, uji me osmozë del nga qeliza duke e vyshkur apo rrudhosur atë dhe citoplazma shkëputet nga membrana duke kaluar në gjëndjen e plazmolizës.

**1 pikë**

*Shpjegon arritjen e turgorit në qelizat bimore 1 pikë*

*Ose*

*Shpjegon arritjen e plazmolizës në qelizat bimore 1 pikë*

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

**Pyetja 16 (b) 1 pikë**

**Përgjigje:**

**1 pikë**

*Tregoni rolin e turgorit te bimët barishtore 1 pikë*

Presioni i turgorit në bimët barishtore siguron qëndrueshmërinë vertikale të kërcellit të tyre.

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

**Pyetja 17 B 1 pikë**

**Pyetja 18 3 pikë**

**Pyetja 18 (a) 2 pikë**

**Përgjigje:**

**2 pikë**

*Tregon dy nga dallimet midis qarkullimit të madh të gjakut dhe qarkullimit të vogël të gjakut*  
**2 pikë**

Qarkullimi madh i gjakut fillon nga barkushja e majtë.  
Qarkullimi vogël i gjakut fillon nga barkushja e djathtë.

Gjatë qarkullimit të madh gjaku transporton në të gjitha indet e trupit lëndë ushqimore, hormone, O<sub>2</sub> dhe kthehet në parabarkushen e djathtë i pasur me CO<sub>2</sub>.  
Gjatë qarkullimit të vogël gjaku shkon në mushkëri, ku lë CO<sub>2</sub> dhe pasurohet me O<sub>2</sub> dhe kthehet në parabarkushen e majtë.

**1 pikë**  
*Tregon një nga dallimet midis qarkullimit të madh dhe qarkullimit të vogël të gjakut* **1 pikë**

**0 pikë**  
*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

**Pyetja 18 (b) 1 pikë**

**Përgjigje:**

**1 pikë**  
*Shpjegon pse muskulatura e anës së majtë është më e zhvilluar se muskulatura e anës së djathtë vlerësohet me* **1 pikë**

Muskulatura e barkushes së majtë është më e zhvilluar se muskulatura e barkushes së djathtë, sepse pompon gjakun me forcë më të madhe për një rrugë më të gjatë, për tu shpërndarë në të gjitha indet dhe organet e trupit.

**0 pikë**  
*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

**Pyetja 19 D 1 pikë**

**Pyetja 20 B 1 pikë**

**Pyetja 21 A 1 pikë**

**Pyetja 22 3 pikë**

**Pyetja 22 (a) 2 pikë**

**Përgjigje:**

**2 pikë**

*Tregon dy nga karakteristikat e sipërfaqeve gazshkëmbyese në mushkëri 2 pikë*

Shkëmbimi i gazeve O<sub>2</sub> dhe CO<sub>2</sub> në mushkëri kryhet në alveola ose hojëza. Alveolat kanë këto karakteristika:

- kanë sipërfaqe të madhe
- kanë parete shumë të holla
- janë të lagështa
- pranë tyre kalojnë shumë kapilarë gjaku me parete shumë të hollë

**1 pikë**

*Tregon një karakteristikë të sipërfaqeve gazshkëmbyese në mushkëri 1 pikë*

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

**Pyetja 22 (b) 1 pikë**

**Përgjigje:**

**1 pikë**

*Tregoni rolin e diafragmës në procesin e frymëkëmbimit 1 pikë*

Gjatë frymëmarrjes diafragma ulet poshtë që të rritet vëllimi i kafazit të krahavorit, kurse gjatë frymënxjerrjes diafragma ngrihet lart që të zvogëlohet vëllimi i kafazit të krahavorit.

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

**Pyetja 23 C 1 pikë**

**Pyetja 24 B 1 pikë**

**Pyetja 25    A    1 pikë**

**Pyetja 26    3 pikë**

**Pyetja 26 (a)    1 pikë**

**Përgjigje:**

**1 pikë**

*Tregon dallimin midis lëndës së hirtë dhe lëndës së bardhë te sistemi nervor qendror **1 pikë***

Lënda gri përbëhet nga trupat qelizorë të neuroneve, kurse lënda e bardhë përbëhet nga fijet nervore të neuroneve.

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

**Pyetja 26 (b)    2 pikë**

**Përgjigje:**

**2 pikë**

*Shpjegon çfarë do të ndodhë në rastin e parë **1 pikë***

*Shpjegon çfarë do të ndodhë në rastin e dytë **1 pikë***

***Rasti i parë***

Neurotransmetuesit janë specifikë dhe lidhen në mënyrë specifike me receptorët proteinikë të membranës së neuronit passinaptik. Vetëm kur injektohet neurotransmetuesi (A) do të përcillet informacioni në zonën passinaptike, sepse vetëm ai do të lidhet me receptorët membranorë të neuronit passinaptik.

***Rasti i dytë***

Kur në hapësirën sinaptike injektohet neurotransmetuesi B, informacioni nuk do të përcillet nga neuroni (1) te neuroni (2), sepse ky neurotransmetues nuk njihet nga receptorët që ndodhen në membranën e neuronit(2).

**1 pikë**

*Shpjegon çfarë do të ndodhë në njërin prej rasteve **1 pikë***

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

**Pyetja 27      B      1 pikë**

**Pyetja 28      B      1 pikë**

**Pyetja 29      B      1 pikë**

**Pyetja 30      3 pikë**

**Pyetja 30 (a)    2 pikë**

**Përgjigje:**

**2 pikë**

*Tregoni dy nga dallimet midis procesit të filtrimit dhe procesit të ripërthithjes në nivelin e nefroneve **2 pikë***

Filtrimi ndodh në nivelin e glomerulës me enë gjaku dhe kapsulës së Baumanit, kurse ripërthithja ndodh në tubthin e nefronit.

Gjatë procesit të filtrimit ndodh dukuria e difuzionit të lëndëve, kurse gjatë ripërthithjes ndodh dukuria e transportit aktiv, osmozës.

**1 pikë**

*Tregoni një nga dallimet midis procesit të filtrimit dhe procesit të ripërthithjes në nivelin e nefroneve **1 pikë***

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

**Pyetja 30 (b)    1 pikë**

**Përgjigje:**

**1 pikë**

*Tregon me një shembull një nga funksionet homeostatike të veshkave **1 pikë***

Veshkat luajnë rol të rëndësishëm në ruajtjen në normë të parametrave homeostatikë të mjedisit të brendshëm.

Për shembull:

- ruajtjen në normë të sasisë së ujit në mjedisin e brendshëm (osmorregullimi).
- ruajtjen në normë të pH në mjedisin e brendshëm, jonet  $H^+$ , dhe  $OH^-$ .
- ruajtjen në normë të joneve  $Na^+$ ,  $K^+$ .

Etj.....

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

**Pyetja 31      B      1 pikë**

**Pyetja 32      D      1 pikë**

**Pyetja 33      3 pikë**

**Pyetja 33 (a)      1 pikë**

**Përgjigje:**

**1 pikë**

*Tregon një nga funksionet e stomakut si pjesë e aparatit tretës **1 pikë***

Stomaku ka funksion:

- Rezervues të ushqimit.
- Tretjen mekanike të ushqimit përmes tkurrjes së muskulaturës.
- Përthith ujin, alkoolin etj.....
- Funksion mbrojtës sepse acidi klorhidrik shkatërron patogjenet që merren me anë të ushqimit.
- Tretjen kimike me anë të enzimave. Enzima pepsinë vepron në prani të acidit klorhidrik për tretjen e pjesshme të proteinave deri në dipeptide.

**Ose**



- Tretjen e proteinave

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

**Pyetja 33 (b) 2 pikë**

**Përgjigje:**

**2 pikë**

*Shpjegon rolin e insulinës ne organizëm 1 pikë*

Insulina është një hormon që ka si funksion të ulë sasinë e tepërt të sheqerit në gjak.

*Tregon mënyrën se si duhet ta marrë i sëmurë insulinën 1 pikë*

Individët e sëmurë me diabet insulinën e marrin me injeksion, sepse insulina është hormon dhe veprimin e saj e ka kur qarkullon me anë të gjakut.

Ose

Individët e sëmurë me diabet insulinën e marrin me injeksion.

**1 pikë**

*Shpjegon rolin e insulinës 1 pikë*

*Ose*

*Tregon mënyrën se si duhet ta marrë i sëmurë insulinën 1 pikë*

**0 pikë**

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

**Pyetja 34 2 pikë**

**Pyetja 34 (a) 1 pikë**

**Përgjigje:**

**1 pikë**

*Tregon hallkat e një prej zinxhirëve ushqimorë që përmban katër nivele trofike 1 pikë*

Barishte, miu, gjarpri, fajkoi

## Ose

Barishte, miu, bufi, fajkoi

### 0 pikë

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

## Pyetja 34 (b) 1 pikë

### Përgjigje:

### 1 pikë

*Tregon dallimin midis prodhuesve dhe konsumatorëve në një zinxhir ushqimor, duke iu referuar mënyrës së të ushqyerit 1 pikë*

Prodhuesit janë gjallesa autotrofe. Këto gjallesa përmbajnë klorofil, prandaj e prodhojnë vetë lëndën organike gjatë procesit të fotosintezës.

Konsumatorët janë gjallesa heterotrofe, të cilat e marrin të gatshme lëndën ushqimore nga nivelet më të ulta trofike.

### 0 pikë

*Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*

### Shënim:

- Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.
- Kur pyetja kërkon që nxënësi të tregojë dallimet midis dy koncepteve ose dy proceseve, nxënësi do të marrë pikë të plotë kur tregon dallimin midis dy koncepteve ose dy proceseve, (jo kur tregon karakteristikat vetëm të njërit prej tyre).

QSHA 2021